



Pranuar / Dorezuar Prijmjeno/Prodato Received/Deliverty	27 - 12 - 2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIKMSIK	7687/	2023	1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1340/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi Anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1340/2023 të datës 27.10.2023 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson avokati me adresë:

kundër Vendimit me numër protokolli 4504/2 të datës 26.10.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike "Pezullim parandalues", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.12.2023 mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1340/2023 e datës 27.10.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër protokolli 4504/4 i datës 27.10.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

A r s y e t i m

Ndaj Ankuesit i punësuar në pozitën e punës "Drejtor i IBK" në Departamentin Instituti Bujqësor i Kosovës në Komunën e Pejës sipas Akt Emërimit me numër protokolli 462 të datës 20.02.2013, më datë 26.10.2023 Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 4504/2 përmes të cilit ankuesin e ka pezulluar sipas detyrës zyrtare, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata, ndalim nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj.

Ankuesi kundër Vendimit me numër protokoli 4504/2 të datës 26.10.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 27.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 6710/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Vendimi me numër protokoli 4504/2 të datës 26.10.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është nxjerrë me shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.11.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa Këshilli më datë 23.11.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 08.12.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë vendimin VK/2023 përmes të cilit ankesës së ankuesit A.nr.1340/2023 ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 6710/2023 të datës 27.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga F.G. për B.B. etj. i datës 20.10.2023; E-mail nga F.G. për B.B. etj. i datës 26.10.2023; Thirrje për shqyrtim fillestar Gjykata Themelore Pejë për F.G. me numër P.nr.283/20; Aktakuzë nga Prokuroria Themelore Gjykata Themelore Departamenti i Përgjithshëm Pejë me numër PP/II nr.1994/19 i datës 28.04.2020; E-mail nga V.Ç për I.R. etj. i datës 26.10.2023; Autorizim nga F.G. për avokatin H.S. i datës 26.10.2023; Vendim me numër protokoli 4504/2 i datës 26.10.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 17.11.2023; Përgjigje në ankesë i datës 23.11.2023; Akt Emërim i F.G. me numër protokoli 462 i datës 20.02.2013; shpallje e konkursit për pozitën "Drejtor" Instituti Bujqësor i Kosovës në Komunën e Pejës në gazetën Epoka e Re i datës 20.02.2010; Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për pezullim të përkohshëm nga puna sipas detyrës zyrtare të protokolluar me Nr.4504/2 të datës 26.10.2023 me numër protokoli 4504/4 i datës 27.10.2023; E-mail nga V.Ç. për F.M. i datës 21.11.2023; E-mail nga F.G. për B.B. etj. i datës 26.10.2023; E-mail nga F.M. për A.A. i datës 31.10.2023; E-mail nga E.Z. për F.M. i datës 31.10.2023; Vendim i MBPZHR me numër protokoli 4504/7 i datës 06.11.2023; E-mail nga F.I. për A.A. i datës 07.11.2023; Procesverbal i shqyrtimit fillestar Gjykata Themelore Pejë me numër P.nr.283/20 i datës 26.10.2023; Kërkesë për vlerësim dhe interpretim të ligjshmërisë i datës 13.10.2023; E-mail nga V.Ç. për F.M. i datës 21.11.2023; E-mail nga V.Ç. për I.R. i datës 08.11.2023; E-mail nga F.G. për N.A. i datës 08.11.2023; E-mail nga N.A. për F.G. i datës 07.11.2023; E-mail nga F.G. për N.A. i datës 31.08.2023; E-mail nga N.A. për F.G. i datës 30.08.2023; Vendim me numër protokoli 7373/2023 i datës 08.12.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka nxjerrë Vendimin me numër protokollit 4504/2 përmes të cilit ankuesin e ka pezulluar sipas detyrës zyrtare, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata, ndalim nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj.

Këshilli me datë 17.11.2023 i është drejtuar me kërkesë për përgjigje në ankesë Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit. Ndërsa pas pranimit të përgjigjes në ankesë të datës 23.11.2023 nga Menaxherja e Personelit drejtuar Këshillit, në shkresat e lëndës të dërguara nga institucioni konkretisht Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Kolegji ka gjetur se ankuesit sipas Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për pezullim të përkohshëm nga puna sipas detyrës zyrtare të protokolluar me Nr.4504/2 të datës 26.10.2023 me numër protokollit 4504/4 i datës 27.10.2023 sipas paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të këtij vendimi: 1. Ndryshohet dhe Plotësohet pika 3 e vendimit bazik të protokolluar me numër 4504/2 të datës 26.10.2023 si vijon: 1.1. Të pezulluarit sipas detyrës zyrtare në pozitën e Drejtorit të Institutit Bujqësor të Kosovës në Pejë i ndalet pagesa e kompensimit të mjeteve financiare në vlerë prej njëzet e pesë për qind (25%) të pagës bazë për periudhën kohore deri në gjashtë muaj nga data e pezullimit të datës 26.10.2023. Si rrjedhojë e kësaj, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 69 të Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Me dispozitat e nenit 68 dhe 69 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit me numër Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik është përcaktuar që: „ 1.Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil që bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; 1.2. me kërkesë të nëpunëses/it civil”, si dhe nenin 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 „1.5. ndaj nëpunëses/it civil është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të saj/tij” si dhe nenin 71 „ 1. Pas përfundimit të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, sipas këtij ligji, nëpunësja/i civil rikthehet në pozitën e mëparshme të punës. 2. Në rast se pozita e mëparshme është e plotësuar përfundimisht, nëpunësja/i civil transferohet në një pozitë tjetër të nivelit profesional. Ndërsa, për nëpunësen/ine nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues, nëpunësja/i kthehet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar. 3. Nëpunësja/i civil pezulluar sipas nenit 69, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 dhe 1.10 që bëhet në pajtim me planifikimin e institucionit, pas përfundimit të pezullimit, kthehet në pozitën e njëjtë apo pozitë ekuivalente. 4. Në rastin e pezullimit për një afat deri në tre (3) muaj, pozita e mëparshme e punës nuk plotësohet deri në përfundimin e pezullimit. Ndërsa në rastet e pezullimit si në nën-paragrafit 1.1. të nenit 70 të këtij ligji, vendi i punës nuk plotësohet deri në një (1) vit. 5. Periudha e pezullimit, në rastet e përcaktuara në paragrafin 1, nën-paragrafët 1.1., 1.3, 1.9., 1.10. dhe 1.11. të nenit 69 dhe paragrafin 1, nën-paragrafin 1.1. të nenit 70 të këtij ligji, llogaritet si përvojë pune në shërbim civil. 6. Periudha e pezullimit, në rastet e përcaktuara në paragrafin 1, nën-paragrafët 1.4., 1.5., 1.6. dhe 1.7. të nenit 69 të këtij ligji do të llogaritet si përvojë pune në shërbimin civil, në rast se nëpunësja/i civil shpallet e/i pafajshëm me vendim të formës së prerë, apo në rast se procedura penale përfundon për shkaqe të tjera. 7. Nëpunësja/i civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1, nën-paragrafët 1.1. dhe 1.10. të



nenit 69 të këtij ligji, nëpunësja/i civil përfiton pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtesë në pagë, për një periudhë pezullimi deri në gjashtë (6) muaj. 8. Nëpunësja/i civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1., nën-paragrafët 1.4., 1.5., 1.6. dhe 1.7. të nenit 69 të këtij ligji, nëpunësja/i civile përfiton pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtesë në pagë, deri në fund të periudhës së pezullimit. 9. Në rast se procedura disiplinore apo procedura penale përfundon pa një masë disiplinore, gjegjësisht dënim penal, nëpunëses/it civil që ka qenë e pezulluar me pesëdhjetë për qind (50%) të pagës së saj/tij, i kompensohet pjesa e ndaluar e pagës bazë.

Kolegji i Këshillit gjatë administrimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Prokuroria Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Pejë ka ngritur Aktakuzë me numër PP/II nr.1994/19 të datës 28.04.2020 lidhur me zhvillimin e procedurës penale ndaj ankuesit për shkak se: Nga data 27-29 Gusht 2019 në Pejë, lagja "Fidanishte", në mënyrë arbitrare ushtron të drejtën që mendon se i takon në vend që ti drejtohet organit kompetent dhe atë në dëm të dëmtuarit G.K., në atë mënyrë që, i pandehuri si Drejtor i Institutit të Bujqësor të Kosovës, banesën e të dëmtuarit me nr. 4309/3 me sipërfaqe prej 63m katror në mënyrë arbitrare i'a rrënon duke menduar se i takon e drejta e pronësisë Institutit, në vend se ti drejtohet Gjykatës kompetente për të vendosur lidhur me pronësinë fillimisht, - me këtë ekziston dyshimi i bazuar mirë se ka kryer vepër penale "Vetëgjyqësia" nga neni 410 par. 1 i KPRK-së. Nga data 27-29 Gusht 2019 në Pejë, lagja "Fidanishte", në mënyrë arbitrare ushtron të drejtën që mendon se i takon në vend që ti drejtohet organit kompetent dhe atë në dëm të dëmtuarit G.Sh., në atë mënyrë që, i pandehuri si Drejtor i Institutit të Bujqësor të Kosovës, banesën e të dëmtuarit me nr. 4309/3 me sipërfaqe prej 96m katror dhe garazhin e tij me sipërfaqe prej 31m katror, në mënyrë arbitrare i'a rrënon duke menduar se i takon e drejta e pronësisë Institutit, në vend se ti drejtohet Gjykatës kompetente për të vendosur lidhur me pronësinë fillimisht, - me këtë ekziston dyshimi i bazuar mirë se ka kryer vepër penale "Vetëgjyqësia" nga neni 410 par. 1 i KPRK-së.

Andaj, duke marr parasysh këtë fakt, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka vendosur për refuzimin e ankesës së ankuesit pasi që ka konstatuar që Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për pezullim të përkohshëm nga puna sipas detyrës zyrtare të protokolluar me Nr.4504/2 të datës 26.10.2023 me numër protokolli 4504/4 i datës 27.10.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është nxjerrë në pajtim me dispozitat e legjislacionit të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik që kanë të bëjnë me pezullimin parandalues të nëpunësve civilë. Organi i punësimit përkatësisht, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është e obliguar që të zbatojë dispozitat e nenit 69 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik për të gjithë nëpunësit civil të punësuar në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për të cilët janë përmbushur kushtet për pezullimin parandalues. Si rrjedhojë e kësaj Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se me rastin e nxjerrjes së Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për pezullim të përkohshëm nga puna sipas detyrës zyrtare të protokolluar me Nr.4504/2 të datës 26.10.2023 me numër protokolli 4504/4 i datës 27.10.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të ankuesit, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.




Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1340/2023

Çlirim Zeka  
  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet;**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.